



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT KOSOVSKE POLICIJE
KOSOVO POLICE UNION

REFERENCË:	SPK-01/017/22	DATË:21.09.2022
PËR/ZA/TO:	z.Hekuran Murati Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve	
CC:	z. Atdhe Hykolli Kryetar i BSPK-së	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtëpërdrejt	
NGA/OD/FROM:	z.Imer Zeqiri Kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë	

I nderuar z.Murati-Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Me datë 15.09.2022, nga Thesari i Kosovës kemi pranuar njoftimin për procesin e dixhitalizimit të deklarimit të anëtarësisë sindikale përmes platformën e-Kosova.

Ju njoftojmë se Federata Sindikale "Sindikata e Policisë së Kosovës" është e regjistruar në Minsitrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, sipas Udhëzimit Administrativ Nr.04/2020.

Për këtë kemi Vendimin me numër të protokollit 0185 të datës 12.04.2022 si dhe Çertifikatën me numër 0185120422 të lëshuar me datë 19.04.2022 nga Minsitria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Po ashtu Federata Sindikale "Sindikata e Policisë së Kosovës" ka të deklaruar të gjithë anëtarët e sindikatës në Thesarin e Kosovës të cilët personalisht kanë plotësuar në mënyrë vullnetare deklaratat për anëtarësim e nga njëherë edhe për ç'anëtarësim. Deklaratat për anëtarësim dhe eventualisht për ç'anëtarësim dërgohen për çdo muaj në Thesrin e Kosovës, të cilat mund të verifikohen.

Njoftimi të cilin e kemi marrë, nuk mund të realizohet për kohën të cilën e keni kërkuar, por edhe vështirë që të realizohet, sepse një numër i madh i punonjësve të policisë nuk kanë çasje në internet.

Andaj Sindikata e Policisë së Kosovës kërkon nga autoriteti i Juaj që të anuloni këtë proces të regjistrimit sepse konsiderojmë që fillimisht është dashur të diskutohet se a mund të bëhet dhe pse duhet të bëhet, por edhe është në kundërshtim me Ligjin mbi organizimin sindikal nr.04/L-011.

Nëse vazhdohet me këtë proces do të sjell paknaqësi te anëtarësia dhe strukturat e sindikatës.

Për të sqaruar dhe tejkaluar çdo paqartësi, kërkojmë që në afat sa më optimal të realizojmë një takim.

Kësaj kërkesë i bashkëngjesim:

1. Vendimin për regjistrimin e Federatës Sindikale "Sindikata e Policisë së Kosovës"
2. Çertifikatën.

Me respekt:

Imer Zeqiri

Kryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës

